



REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar / Prenheno / Predata / Received / Delivered	19-01-2022	viti / год / year	2
Organ / Agjencia / Organ / Agencija / Org / Unit	SKDMSHICK	Hi Prof / Br Prof / Prof No	246/2022
Shtesa / Prilog / Appendix		Sasia / Kolicina / Quantity	1/3



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1226/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari-kryetare, Jeton Koca dhe Eshref Shabani-anëtar dhe Zyle Millaku Gojnovci-Zyrtare e lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1226/2021 të datës 28.12.2021, të parashtruar nga ankuesi me adresë banimi Komunë të Prishtinës, kundër organit të punësimit Organi Shqyrtues të Prokurimit, në çështjen juridike “masë disiplinore-vërejtje me shkrim” duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datën 18.01.2022, mori këtë:

V E N D I M

HEDHET poshtë si e palejuar ankesa me numër A.nr.1226/2021 e datës 28.12.2021, e parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi i punësuar në Organin Shqyrtues të Prokurimit sipas Akt emërimit të datës 11.06.2019 me numër të protokollit 604/19 në vendin e punës “Ekspert Shqyrtues” në Divizionin për Shqyrtimin e Ankesave, me datën 28.09.2021 Udhëheqësja e drejtpërdrejtë e ankuesit i ka shqiptuar “vërejtje me shkrim” sipas vendimit me numër 588/21 të datës 25.08.2021 të Komisionit Disiplinor të Organit Shqyrtues të Prokurimit

Udhëheqësja e Drejtpërdrejtë e ankuesit me datë 23.07.2021 me numër 531/21 e ka njoftuar Menaxheren e Personelit të Organit Shqyrtues të Prokurimit për e-mailin e datës 22.07.2021 dhe ka kërkuar që të ndermirren masa ndaj ankuesit në pajtim me nenin 12 të Rregullores për Procedurat Disiplinore, e që një veprim i tillë i Udhëheqësjes së Drejtpërdrejtë të ankuesit është në kundërshtim me e-mailin e datës 22.07.2021 pasi që Kryesuesi i Sekretariatit të Organit Shqyrtues të Prokurimit ka kërkuar nga Udhëheqësja e ankuesit që të ndërmarr masa të menjëhershme për shqiptimin e vërejtjes me shkrim, komfor ligjeve në fuqi dhe kodit të mirësjelljes, rrjedhimisht pa u

iniciuar procedurë disiplinore në Komision Disiplinor ndaj tij por vetëm ti shqiptohet vërejtje me shkrim.

Ankuesi i pa kënaqur me vendimin e datës 28.09.2021 me numër 658/21 të Udhëheqëses së Drejtpërdrejtë të Organit Shqyrtues të Prokurimit me datë 23.09.2021 me numër të protokollit 4758/21 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 19.11.2021 ka nxjerr Vendim me numër A.nr.830/2021 me të cilin është obliguar Udhëheqësja e drejtpërdrejtë e ankuesit të rishqyrtoj lëndën lidhur me „shkeljen e supozuar” sipas kërkesës të datës 22.07.2021 të parashtruar nga Kryesuesi i Sekretariatit të Organit Shqyrtues të Prokurimit.

Udhëheqësja e drejtpërdrejtë e ankuesit me qëllim të zbatimit të vendimit me numër A.nr.830/2021 të datës 19.11.2021 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e ka rishqyrtuar lëndën, dhe më datë 25.11.2021 i ka shqiptuar Vërejtje me shkrim me numër protokollit 839/21, të cilën vërejtje ankuesi e ka pranuar po me të njëjtën date me 25.11.2021.

Ankuesi i pakënaqur Vërejtjen me shkrim me numër protokollit 839/21 të datës 25.11.2021 të shqiptuar nga Udhëheqësja e drejtpërdrejtë e tij, ka parashtruar ankesë me numër protokollit 6363/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me datë 28.12.2021 .

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me datën 31.12.2021, e ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Organi Shqyrtues i Prokurimit. Me datën 14.01.2022, Këshilli ka pranuar përgjigje në ankesë nga Organi Shqyrtues i Prokurimit me shkresat e bashkangjitura.

**Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, me qëllim të vërtetimit të drejtë të gjendjes faktike dhe për vendosje meritore ka administruar këto prova:** Ankesa e ankueses me numër të protokollit 6363/2021 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; kundër Vërejtjes me nr. 839/21 me shkrim të datës 25.11.2021; Përgjigje në ankesë e datës 14.01.2022; Akt emërimi me numër Nr.104/19 të datës 11.06.2019; Përshkrim i vendit të punës ;Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2019; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2021; Dëshmi nënshkrim i datës 25.11.2021-se kur ankuesi e ka pranuar Vërejtjen me nr. 839/21, nga ana e tij; Vendimi Anr.830/2021 i Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i pranuar me datë 24.11.2021 nga Organi Shqyrtues i Prokurimit.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar shkresat e lëndës të parashtruara nga ankuesi, ka konstatuar se ankesa e ankuesi **është e pa lejuar, sepse:**

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, bazuar në nenin 24 paragrafi 3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, ka konstatuar se nëpunësi civil ka të drejtë të paraqesë ankesë drejtpërdrejt në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil për çdo veprim apo mosveprim, që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto, që burojnë nga marrëdhënia e Shërbimit Civil, ndërsa Ligji Nr.05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative neni 127 paragrafi 1 përcakton se : **“Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve, nga data kur është njoftuar për aktin administrativ”.**



Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, bazuar në dëshmitë e ofruara nga organi i punësimit dhe ankuesi, ka konstatuar se ankuesi Vërejtjen me shkrim me numër protokolli 839/21, te datës 25.11.2021 të shqiptuar nga Udhëheqësja e drejtpërdrejtë e tij e ka pranuar me datë 25.11.2021, ndërsa ankesën në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me numër protokolli 6363/21 kundër Vërejtjes së shqiptuar të datës 25.11.2021 nga Udhëheqësja e drejtpërdrejtë e tij, e ka parashtruar me datës 28.12.2021, jashtë afatit ligjor, të përcaktuar me nenin 127 paragrafin 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: *"Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve, nga data kur është njoftuar për aktin administrativ"*. Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka vlerësuar se ankuesi nuk e ka shfrytëzuar të drejtën e ankimimit për parashtrimin e ankesës në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditëve, nga data kur është njoftuar me Vërejtjen e datës 25.11.2021 te shqiptuar nga Udhëheqësja e drejtpërdrejtë e tij, sepse ne rastin konkret në bazë të dëshmisë së ofruar nga organi i punësimit ankuesi Vërejtjen e ka pranuar dhe nënshkruar në të njëjtën datë gjegjësisht me datën 25.11.2021, andaj në kuptim të kësaj dhe nenit 18 paragrafit 1 nën paragrafit 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ankesa e ankuesit është e pa lejuar.

Andaj, duke u bazuar në nenin 129 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, si dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë - Departamenti Administrativ, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda me numër A.nr.1226/2021.

Zyle Milaku GOJNOVCI

Zyrtarë e Lartë për Bashkëpunim Profesional

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

**Vendimi i dërgohet**

- Ankuesit
- Kryesuesit të Sekretariatit të Organit Shqyrtues të Prokurimit;
- Menaxher të Personelit të Organit Shqyrtues të Prokurimit dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

